

LANGUAGE DEVELOPMENT IN CHILDREN, IMPORTANCE AND STAGES

Shadan RAMADANI¹

¹ *Department of German Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

**Corresponding author e-mail: shadan.ramadani@unite.edu.mk*

Abstract

The question arises as to why in a study we should start treating the early development of the child and at the same time the development before his birth, in the same way that Bernhard Müßgens started the first lesson in the field of teaching-receiving. When it comes to the child's language development, a phenomenon that is an important prerequisite for their success at school, for start we must find the reason that why does this problem appear and how can we cope with them.

Given the very heterogeneous conditions at the beginning of learning and also starting from the point of view of the beginning of this integration procedure in our country, the necessary knowledge about language development is essential. We must bear in mind that in the first grade we are dealing with children of different developmental levels. By the beginning of the first grade, the range of what we can call normal development includes a period of time of 3 years. But there are also children whose development did not proceed normally and who in fact have been subjected to disorders that have affected in one form or another individual area of development.

Keywords: Language, child, early learning, pedagogy.

Hyrje

Sikurse që e ka nisur Bernhard Müßgens orën e parë në fushën e mësimdhënies-marrjes, duhet të shtrojmë pyetjen se përse në një studim duhet të fillojmë të trajtojmë zhvillimin e hershëm gjuhësor të fëmijës, gjithashtu njëkohësisht edhe zhvillimin para lindjes së tij. Pra, çfarë rëndësie ka zhvillimi para lindjes dhe pas saj tek një fëmijë, si ndikon kjo periudhë në këndvështrimin gjuhësor të tij?! Megjithatë duhet theksuar se shfaqja e gjuhës dhe trajektorët e zhvillimit të aftësive të ndryshme gjuhësorë karakterizohen nga prania e një ndryshueshmërie të konsiderueshme, që ka të bëjë me kohën, metodat, strategjitë e përvetësimit dhe të të mësuarit të fëmijëve.

Kur bëhet fjalë për zhvillimin e gjuhës te fëmija, fenomen që është parakusht i rëndësishëm për suksesin në shkollë, së pari, duhet të gjejmë arsyet se përse shfaqen këto probleme dhe si mund t'i përballojmë ato. Duke pasur parasysh kushtet shumë heterogjene në fillimet e mësimarrjes dhe gjithashtu duke u nisur nga pikëpamja e nisjes të kësaj procedure integrale në vendin tonë, njohuritë e nevojshme rreth zhvillimit të gjuhës janë të domosdoshme. Duhet të kemi parasysh se që në klasën e parë kemi të bëjmë me fëmijë të niveleve të ndryshme zhvillimore, qofshin ato psikologjike, sociale apo kulturore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e tyre.

Me fillimin e shkollimit diapazoni i asaj që mund ta quajmë zhvillim normal përfshin një periudhë kohore prej 3 vitesh. Por, gjithashtu ka dhe fëmijë, zhvillimi i të cilëve, nuk ka rrjedhur normalisht e që në fakt i janë nënshtruar çrregullimeve, të cilat kanë prekur në një formë apo tjetër fusha individuale të zhvillimit të tyre. Nëse do të arrij që gjuhën ta analizoj në kontekstin e fushave të ndryshme zhvillimore, atëherë gabimet mund të interpretohen si sinjale të mungesës së mundësive për zhvillim dhe në këtë rast fëmijës t'i bëjmë një ofertë të përshtatshme. Kjo nuk nënkupton se duam të ofrojmë një organizim për logopedi apo të interpretohet nga ky këndvështrim.

Përkundrazi e rëndësishme është që të kuptojmë se kur duhet të inkuadrohen ekspertët, dhe, nga ana tjetër, si mund në mësimdhënie të planifikojmë një ofertë gjithëpërfshirëse dhe njëkohësisht promovuese. Kuptohet se njohuritë bazë shërbejnë si ndihmë në ngritjen e parakushteve mësimore të nxënësve me kapacitete të ndryshme dhe njëkohësisht planifikimi i mësimdhënies së diferencuar, të dyja këto së bashku përbëjnë atë që tashmë shkollat, por edhe vet sistemi ka si qëllim.

Shtrohet pyetja se cilat fusha shkollore relevante të zhvillimit gjuhësor mund t'i dallojmë? Ato janë:

- a) Aspektet e zhvillimit perceptues,
- b) Aspektet e zhvillimit psiko-sociolinguistik të të folurit (p.sh. nivelet gjuhësore).

1. Zhvillimi i gjuhës te njerëzit

Sipas Breuer/Weuffen është e padiskutueshme, se aftësitë e mira sensomotorike perceptuese dhe diferencuese janë parakusht për përvetësimin e gjuhës së folur dhe të shkrimit (Breuer, H. / Weuffen, M., 1996, fq. 3.). Në bazë të kësaj mund të nënkuptohet se fëmijët shpejtë do të jenë në gjendje të prodhojnë tinguj dhe të kyçen në zhvillimin e tyre.

Disa zhvillime perceptuese janë të ndërlidhura me gjuhën, si në vijim:

- a) Aftësia e diferencimit ritmik,
- b) Aftësia e diferencimit fonematik,
- c) Aftësia e diferencimit melodik,
- d) Aftësia e diferencimit vizual,
- e) Aftësia e diferencimit të ndjesisë së lëvizjes.

Së pari do të ndalem dhe shtjelloj pesë zhvillimet e aftësisë perceptuese dhe më pas do të vazhdoj me zhvillimin e parakushteve.

a) Aftësia e diferencimit ritmik

Ritmi i shërben gjuhës si instrument strukturor, si për shembull aktiviteti dhe pushimi, rrokje të theksuara dhe të patheksuara, pushimi i frymëmarrjes, etj. Kjo strukturë e bën më të lehtë për të kuptuar dhe me siguri shumica kanë përjetuar se sa e vështirë dhe rraskapitëse është të dëgjoni dikë, i cili gjatë të folurit merr frymë në kohën e gabuar dhe shqipton gabimisht ose flet me theksim të dobët. Ky fenomen mund të qartësohet nëse provoni të thoni një herë numrin e celularit personal dhe njëkohësisht të vëreni ritmin.

Nga kjo mund të konstatohet se ritmet mund të kodojnë kuptime. Nuancat ritmike janë shpesh udhëzues kryesor në kulmin semantik në një fjali. Prandaj aftësia për të njohur ritmet është një parakusht i rëndësishëm për të kuptuar gjuhën e folur, dhe njëkohësisht për të prodhuar ritme është një parakusht për të folur.

b) Aftësia e diferencimit fonematik

Aftësia e dallimit të fonemave është një performancë akustike, e cila është ngushtë e ndërlidhur me gjuhën. Sekuenca e elementeve gjuhësore të artikuluar dallohet nga rrjedha e tingujve. Kjo aftësi është parakusht i rëndësishëm për përvetësimin jo vetëm të të folurit por edhe të shkrimit, si dhe është një performancë perceptues dhe kognitive. Le të marrim për shembull njësi me kuptime të ndryshme në fjalë të shkurtra: (r/rr) rasë, rrasë; arë, arrë ose (t/d) tyta, dita etj. Fëmija duhet t'i dëgjojë këto dallime dhe të mësojë t'i realizojë ato në aspektin e të folurit motorik.

c) Aftësia e diferencimit melodik

Melodia e të folurit përcjell gjendje emocionale si për shembull të butë, lutëse, energjike etj. Ajo është karakteristike e çdo dialekti përkatës. Prandaj mund të konstatohet se gjuhët e ndryshme kanë melodi të ndryshme. Supozohet se fëmija fillimisht mëson të kuptojë aspektet melodike të të folurit, që nënkupton se në këtë mënyre shfaq nevojë për kënaqësi dhe mohim. Nëse një tekst prezantohet pa melodi atëherë është më vështirë për t'u kuptuar dhe njëkohësisht ullet interesimi dhe vëmendja.

d) Aftësia e diferencimit vizual

Aftësia e diferencimit vizual luan një rol kyç në mësimin e të folurit dhe kuptimin e asaj që flitet. Prandaj mund të thuhet se foshnja bëhet e vëmendshme në aparatën e artikulimit duke vëzhguar edhe shprehjet e fytyrës apo lëvizjet e gojës të personit kujdestar. Informacionet vizuale nga goja janë një ndihmë për të kuptuar, por njëkohësisht edhe për të zhvilluar te ajo aftësinë për të folur.

e) Aftësia e diferencimit të ndjesisë së lëvizjes

Si aftësi e diferencimit të ndjesisë së lëvizjes nënkuptohet një koordinim i hollësishëm motorik i organeve të të folurit. Ajo formon një njësi të përbashkët me kontrollin dëgjimor të fjalës së folur. Nga kjo rezulton se njerëzit e shurdhër e kanë qatë vështirë të mësojnë të flasën. Qëllimi është perfeksionimi i konceptimit të ndjesisë së lëvizjes të të folurit dhe kujtesës së muskujve për të folur. Në vitet e para të jetës performancat motorike të të folurit të fëmijës janë ngushtë të ndërlidhura me performancat e aftësive të përgjithshme motorike. Në vijim do të shtjelloj zhvillimin e gjuhës, i cili është shumë më tepër sesa zhvillimi i parakushteve perceptuese gjuhësore.

2. Zhvillimi para lindjes

Disa kontribute perceptimesh iniciohen që në fazën para se njeriu të flasë, madje edhe më herët, respektivisht para lindjes. Kështu që sipas Jantzen funksionet e receptorit zhvillohen qysh në gjashtë javët e para të shtatzënisë. Rreth javës së tetë të shtatzënisë zhvillohet ndjeshmëria në zonën e gojës, fytyrës dhe qafës dhe nga java e dhjetë në gjithë lëkurën. Nga java e trembëdhjetë e shtatzënisë fëmija mund të nuhasë dhe të shijojë. Dhe nga java e katërbëdhjetë funksionon sistemi vestibular. Megjithatë këto të dhëna kohore sikurse në të gjitha përshkrimet zhvillimore duhet të trajtohet me shumë kujdes, sepse devijimet lartë ose më poshtë janë të mundshme. Më së voni nga java e njëzetënjë e shtatzënisë fëmija mund të analizojë sinjale akustike dhe fillojnë reaksione orientuese.

Nga java e njëzetegjashtë të shtatzënisë fëmija mund të shohë dhe së shpejti i përgjigjet si stimujve akustik, po ashtu dhe atyre vizualë (Jantzen, Wolfgang, 1987, fq. 182). Zhvillimi i perceptimit shkon paralelisht me zhvillimin e lëvizjes. Rreth javës së shtatë të shtatzënisë fëmija fillon të lëvizë dhe në javën e trembëdhjetë tanimë mund të thithë gishtin e madh, të gëlltisë, të kthejë kokën dhe të lëvizë krahët dhe këmbët. Nga java e gjashtëmbëdhjetë është i pranishëm refleksi i kapjes. Në javën e njëzetekatër vërehen periudha zgjimi dhe pushimi. Nga java e njëzetetë fëmija mund të ngërdheshet, buzëqeshë dhe të rruddh ballin. Në javën e tridhjetetreta fëmija fillon të zhvillojë modele të koordinuara të lëvizjes. Të paktën në gjashtë javët e fundit të shtatzënisë fëmijët tanimë janë në gjendje të vërejnë ritme gjuhësore gjatë dëgjimit.

Fëmijët e sapo lindur janë në gjendje të njohin një tregim që i lexohet shpesh, mbi të gjitha në interval kohor të theksimit dhe pauzave (De Casper, A./ Spence, M., 1980, fq. 133-150). Mund të konstatohet se aftësia e diferencimit fonematik, si zhurma, tingulli i lartë, dhe fillimet e diferencimit melodik janë mjaft qartë të pranishme gjatë shtatzënisë (Tomatis, A., 1978, fq. 25). Edhe një reagim ndaj stimujve vizual zhvillohet në javën e njëzetentë dhe në fund të shtatzënisë fëmija mund të kontrollojë rruddhjen e fytyrës së saj (Jantzen, W., 1987) dhe do të ketë aftësitë e para të ndjesisë së lëvizjes.

2.1 Zhvillimi pas lindjes dhe para se të flasë

Zhvillimi i performancës perceptuese gjuhësore nuk i paraprin qartë ose fare zhvillimit aktual të gjuhës. Përkundrazi, të gjitha fushat e zhvillimit janë të ndërlidhura dhe ndikojnë reciprokisht njëra-tjetrën në zhvillimin e tyre specifik. Pas lindjes fillon faza paragjuhësore dhe sipas Grohnfeldt dallojmë dy faza kryesore:

- Fazat e të qarat në javën e parë deri të shtatën. Këto faza diferencohen shpejtë sipas nevojave të ndryshme të fëmijës. Fillimisht mbizotërojnë tingujt e ngjashëm me zanoret dhe më vonë kryesojnë bashkëtingëlloret me origjinë glotale. Nga java e gjashtë deri në javën e tetë dëgjoen tinguj pëshpëritëse dhe gugatëse, dhe
- nga muaji i dytë deri në muajin e dymbëdhjetë është periudha e fjalëve/lafshmërisë. Në këtë fazë janë të mundshëm të gjithë tingujt dhe duke ndjekur dhe imituar nënën monologët e ngatërruar japin një efekt komunikues dhe së shpejti ata mund të përdoren qëllimshëm. Ndërkohë pason ridyfishimi i tingujve pëshpëritës dhe gugasi për shembull: nana, dada, baba etj. Diku rreth muajit të pestë fillojnë proceset e dëgjimit dhe të folurit. Fillimisht përmes vetëimitimit, më pas përmes imitimit të melodisë dhe ritmit të të folurit (Grohnfeldt, M., 1989, fq. 55). Në këtë periudhë fëmijët që nuk dëgjojnë rrezikohen të jenë memec.

Ndërsa autori Bruner mendon se bazat e gjuhës ekzistojnë në modelet paragjuhësore (Bruner, J. S., 1974, fq. 255-287). Prandaj gjuha është vazhdimësia e veprimeve të përbashkëta ndërmjet nënës dhe fëmijës. Nëna u jep kuptim modeleve të përbashkëta-zakonshme të veprimit. Kur fëmija mundohet të shpreh diçka, atëherë nëna i jep shprehjes kuptim të caktuar dhe këtë kuptim fëmija e pranon. Në vazhdimësi fëmija vepron në këtë mënyrë duke pritur interpretimin e saktë të nënës. Si pararendëse të akteve të të folurit evoluojnë katër mënyra:

- mënyra e dëshirës,
- mënyra e kërkesës,
- mënyra e shkëmbimit dhe
- mënyra e plotësimit.

Bruner është i mendimit se këto modele veprimi nuk janë vetëm format e hershme të komunikimit, por njëkohësisht dhe format e hershme të gramatikës si dhe pararendëse të strukturave gramatikore. Ndërsa Chomsky pretendon të kundërtën, i cili thotë se strukturat specifike gjuhësore janë të lindura (Chomsky, Noam, 1970, fq. 18-21). Autorë të tjerë supozojnë se fëmija ka një qëllim real dhe vlerësojnë se ndikimi i nënës në konfrontimin komunikues është tejet i ulët.

Për shembull, Schieffelin, raporton për disa fëmijë nga Papua - Guinea e Re, të cilët nuk komunikojnë në fazën preverbale. Megjithatë, këta fëmijë e mësojnë gjuhën e tyre amtare pa vonesë. Të njëjtën konstaton edhe Ochs nga Samoa që gjendet në ishujt e Polinezisë. (Slobin, D. I., 1985). Luciarello, Kyratzis dhe Engel mendojnë se interpretimi i nënës si ofertë gjuhësore për një kontekst të përbashkët veprimi mbështet zhvillimin gjuhësor të fëmijës, por nuk mund të konsiderohet si një parakusht i domosdoshëm (Slobin, D. I., 1986). Kjo fazë paragjuhësore është e pranishme në të gjitha kulturat - qoftë me ose pa ndikimin e nënës në komunikim. Në fakt komunikimi është motori kryesor në zhvillimin i gjuhës. Vështruar në relacionin e ngushtë nënë-fëmijë do të thotë se komunikimi po bëhet gjithnjë e më i ndërlikuar.

3. Fazat dhe strukturat gjuhësore

Gjuha përfshin të gjitha format e komunikimit, qofshin ato të shprehura me gojë, me shkrim, shenja të ndryshme si gjestet ose shprehjet e fytyrës. Ndërsa të folurit është një nga format më efektive të komunikimit dhe, njëkohësisht, konsiderohet më e rëndësishmja dhe e përdorur gjerësisht. Zhvillimi i gjuhës rritet përmes zhvillimit të fëmijëve. Oskaaar Els (2013, fq. 170 - 175) i bashkëngjitet kritikuesve të Bruner-it dhe duke u mbështetur në Clara dhe William Stern (1928), të cilët si kriter përcaktues për zhvillimin gjuhësor përdorin fjalën e parë të qëllimshme dhe kuptimplotë.

Grohnfeldt Manfred (1989) e ndan gjuhën në katër nivele strukturore dhe thotë se zhvillimi gjuhësor zhvillohet në të gjitha nivelet paralelisht.

Nivelet strukturore sipas Grohnfeldt janë:

- niveli fonetik-fonologjik (tingujt)
- niveli semantiko-leksikor (kuptimi)
- niveli sintaksor-morfologjik (gramatikë)
- niveli pragmatiko-komunikues (bisedë)

Se zhvillimi me të vërtetë ndodh paralelisht në të katër nivelet gjuhësore mendoj se është e pakontestueshme.

Zhvillimin gjuhësor ai e ndan sërish në disa faza:

- a) Faza e fjalive me një fjalë në moshën dymbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë muaj. Periudha kur fëmija përshkruan një sërë kuptimesh të ndryshme të mundshme me një fjalë.
- b) Faza e fjalive me dy dhe më shumë fjalë në moshën tetëmbëdhjetë deri njëzetekatër muaj. Në këtë periudhë fëmija kupton dhe percepton se disa fjalë së bashku japin një kuptim të ri, si për shembull: Nëna qumështi etj. Fjalori zgjerohet shumë shpejt: fillimisht me emra, pastaj me folje dhe më pas me mbiemra.
- c) Faza e hershme gramatikore në moshën dy deri tre vjet. Periudha ku fëmija fillon të diferencohet në aspekt sintaksor, përvetëson dhe përdor morfemat (zgjedhon folje dhe lakon emra). Formulon pyetje të thjeshta si për shembull: Pse? Kur? Ku?
- d) Strukturimi morfosintaksor në moshën tre deri katër vjet. Periudha e ballafaqimit me fjali kryesore dhe të varura.
- e) Përafrimi me gjuhën e të rriturve në moshën katër deri gjashtë vjet. Në këtë fazë përmirësimet janë gjithkund të nevojshme, kurse forma pasive fillon të përvetësohet tek në moshën ndërmjet shtatë dhe nëntë vjet.

Kjo analizë e Grohnfeldt nuk do të thotë se është e padiskutueshme në të gjitha pikat dhe besoj se ka mënyra dhe forma të ndryshme të përvetësimit, që varen nga specifika gjinore, klasa, inteligjenca dhe relacioni farefisnor. Pa diskutim se nëna luan një rol vendimtar në zhvillimin e gjuhës dhe suksesin e ndërveprimit me fëmijën e saj. Gati çdo nënë disponon sjellje dhe ndjesi të lindur, të ashtuquajtur intuitë prindërore. Megjithatë, të dhënat studimore lejojnë të konkludojmë se ky repertori i lindur mund të ndikohet nga ndikime të jashtme specifike.

Megjithëse një numër i vogël studimesh e kanë shqyrtuar këtë temë dhe kanë përfundime të ngjashme, autorët Engfer dhe Gavranidou (Rauh, H./Steinhausen, H.C. 1987, fq. 71-99) sugjerojnë se ndjeshmëria e nënës varet nga cilësia e marrëdhënies martesore dhe mirëqenia e saj. Sipas Lamb et. al. (2002) edhe stresi i moderuar mund të ndikojë negativisht në cilësinë e aftësive intuitave respektivisht në zhvillimin e gjuhës te fëmija. Për të qenë më të sigurtë në konkluzionet rreth kësaj teme, është i nevojshëm një studim më thelbësor me një grup fëmijësh, të cilët janë të ekspozuar ndaj ndikimeve të ndryshme.

4. Përfundim

Zhvillimi i gjuhës është një proces i karakterizuar nga një ndryshueshmëri e madhe ndërindividuale. Për arsye, se çdo fëmijë e zhvillon gjuhën sipas kohës dhe aftësive të veta, por edhe për shkak të kompleksitetit të procesit të zhvillimit të gjuhës te fëmijët nuk mund të supozojmë se modelet dhe fazat e paraqitura në punim paraqesin në të vërtetë një zhvillim linear dhe do të vlejnjë për të gjithë.

Shtjellimet në këtë studim tregojnë se është krejt e natyrshme që një fazë të mos vërehet ose që kalimi nga një fazë në tjetrën të marrë shumë kohë dhe të mendohet për aplikime alternative të strategjive. Do të ishte gabim nëse do të fillonim me strategjitë e zhvillimit të sistemit të të folurit dhe do të injoronim funksionin e veprimit dhe zgjidhjes së problemeve në fazat e ndryshme.

Megjithatë është domosdoshmëri që fazat nëpër të cilat kalon zhvillimi linguistik i një fëmije, të jenë në fokus të akteve, qoftë të prindërve, po ashtu edhe të mësuesve, sepse secila ndërlidhet me njëra-tjetrën dhe ndikojnë në zhvillimin e fëmijës. Zhvillimi i gjuhës te fëmijët ndikon drejtpërsëdrejti në të ardhmen e tij dhe njohja e këtij procesi përbën një parakusht në hartimin e shumë politikave arsimore. Një studim thelbësor me një grup fëmijësh të ekspozuar ndaj ndikimeve të ndryshme do të ofronte përfundime më të qarta.

Referencat

- [1]. Breuer, Helmut/ Weuffen, Maria. (1996): Lernschwierigkeiten am Schulanfang. Schuleingangsdiagnostik zur Früherkennung und Frühförderung. Weinheim: Beltz.
- [2]. Bruner, Jerome S. (1974/75): From communication to language - a psychological perspective. Në: Cognition 3.
- [3]. Chomsky, Noam (1970): Aspekte der Syntax-Theorie. Suhrkamp.
- [4]. Clara/ William Stern (1928): Die Kindersprache. Eine psychologische und sprachtheoretische Untersuchung. Leipzig. Pdf në: https://pure.mpg.de/rest/items/item_2389845_3/component/file_2389844/content
- [5]. De Casper, A./ Spence, M. (1980): Prenatal maternal speech influencës newborn's perception of speech sounds. Infant behavior and Development 9.
- [6]. Grohnfeldt, Manfred (1989): Störungen der Sprachentwicklung. Berlin.
- [7]. Jantzen, Wolfgang (1987): Allgemeine Behindertenpädagogik, Bd. 1: Sozialwissenschaftliche und psychologische Grundlagen. Weinheim: Beltz.
- [8]. Lamb, M. E./Bornstein, M. H. / Teti, D. M. (2002). Development in Infancy. Mahwah, New Jersey: Lawrence Erlbaum Associates.
- [9]. Nelson, K. (1986): Event knowledge: Structure and function in development. Nes Jersey.
- [10]. Oskaar Els (Reprint 2013): Spracherwerb - Sprachkontakt – Sprachkonflikt. Verlag: De Gruyter.
- [11]. Rauh, H. /Steinhausen, H.-C. (1987):Psychobiology and Early Development. North Holland.
- [12]. Slobin, D. I. (1985): The Crosslinguistic Study of Language Acquisition. New Jersey.
- [13]. Tomatis, Alfred (1987): Der Klang des Lebens. Hamburg: Rowohlt.